

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i Prokurimit : **KEK - 23 - 6102 - 121**

Nri brendshem : **KEKC- 23 - 229 - 121**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me lidhëse elastike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit *

UNIVERS – M SH.P.K.

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

Rruga Eqrem Qabej

Adresa

Millosevë – Obiliq

15050

Vendi/Kodi postar

044 276 071NA

(Numri Telefonit)/Numri i Faks-it

TEFIK HARGAJA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


e-mail: univers.m.pr@gmail.com

Adresa elektronike

Dt.22.08.2023

Data e parashtrimit të ankesës/Nënshkrimi dhe vula

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratështe publikuar me datë 14.06.2023
- Afati i fundit i dorëzimit të tenderit datë 07.07.2023
- Kriteri i dhenjes së tenderit Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ☒

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Eshte organizuar hapja publike e ofertave ne sistemin e E-prokurimit
Hapja e ofertave nëmenyre elektronike është bërë me dt.07.07.2023 , nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 14.08.2023 përmes platformës së e – Prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim në AK(Autoriteti Kontraktues) – Korporata energjetike e Kosovës sh.a.

Me datë 16.08.2023 përmes e-mailit nga zyrtari i prokurimit ZEP-it kemi pranuar Përgjigjen – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues që Kërkesën tonë për Rishqyrtim e konsideron si të pa bazuar.

Të pa kënaqur me këtë vendim të Autoritetit Kontraktues – KEK sh.a , dhe në afatin kohorë e dërgojmë Ankesën në OSHP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves, me rastin e publikimit të njoftimit për Vendimin e anulimit për aktivitetin e prokurimit për **Furnizim me lidhëse elastike**, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (me tej: LPP), Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik (me tej: Rrpp), Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik (me tej: Upp), të potencuara si vijon:

- Eshtë shkelur neni 1 i LPP-se,
- Eshtë shkelur neni 7 i LPP-se,
- Eshtë shkelur neni 62 i LPP-se,
- Eshtë shkelur neni 43 (5), 43(7) i Rrpp.
-

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Anulimi i aktivitetit të prokurimit nga Autoriteti Kontraktues është bërë në shkelje të nenit 1, nenit 7, nenit 62 të LPP-së, nenit 43(5), (7) të Rregullores për prokurimin publik.

Aktiviteti është publikuar me njoftimin për kontratë me datë 14.06.2023, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 07.07.2023, ku me datën 07.07.2023 është bërë hapja e ofertave dhe pergaditur procesverbali i hapjes në këtë aktivitet të prokurimit kemi qenë të vetmit ofertues.

Me datë 14.07.2023 nga Autoriteti Kontraktues (AK) përmes letrës standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit janë kërkuar informata sqaruese, ku me datë 15.07.2023 është kthyer përgjigjja nga OE "Univers-M" shpk ku është konfirmuar se produktet do të liferohen sipas kushteve të dosjes së tenderit.

Me datë 09.08.2023 nga Autoriteti Kontraktues është nxjerrur vendimi për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me arsyetimin se njësi kërkuese ka konfirmuar se nevojat e tyre kanë ndryshuar nga momenti i inicimit të tenderit prandaj ky aktivitet duhet të anulohet me qëllim që të behen permisimet e nevojshme.

Kjo arsye e njësisë kërkuese edhe logjikisht nuk qëndron sepse aktiviteti është iniciuar dhe publikuar me datë 14.06.2023, kërkesa për informata sqaruese ka qenë me datë 14.07.2023, ndërsa anulimi bëhet me datë 09.08.2023, afat i shkurtër kohor rreth 26 ditë kalendrike nga data e kërkesës për sqarime të behen ndryshime nuk është e arsyeshme, nuk është e argumentueshme as në aspektin e provave as në afatin kohor, dhe rrjedhimisht është në shkelje të rregullave të prokurimit publik.

Pretendimet, indiciet për anulim mund të jenë pasi që është bërë kërkesë për rishqyrtim me datë 09.08.2023 për një aktivitet tjetër me nr.prok KEK-23-1746-121, nr.brendshëm KEKO-23-070-121 dhe kemi dilema se anulimi është bërë pikërisht për shkak të kërkesës për rishqyrtim për këtë aktivitet, ku me herët OSHP me vendimin nr.2023/0251 me datë 23.06.2023 ka aprovuar ankesën e OE "Univers-M" shpk.

OE "Univers-M" shpk është i siguarur të ndjek të drejtat e veta të siguruara dhe garantuara me ligj, përvojën dhe ekspertizën që ka në këtë fushë për këto aktivitete dhe të sigurojë jetën dhe bërjen e biznesit duke ndjekur rregullat e aplikueshme.

Ndërsa AK pa arsye dhe baze ligjore anulon aktivitetin gjoja se nevojat e tyre kanë ndryshuar nga momenti i inicimit të këtij tenderi, ku sipas arsyes se AK çdo aktivitet mund të anulohet me një arsyetim për ndryshim kërkesë të kontratës të bëhet anulimi, edhe atë për një kohë të shkurtër nga data e inicimit të aktivitetit me publikimin e njoftimit për kontratë që edhe profesionalisht, e teknikisht është e pamundur të pesoje ndryshime kërkesa e njësisë kërkuese, pos arsyetimeve jo ligjore të bazuara në rregulla të prokurimit publik për të anuluar aktivitetin. Ky precedent është me risk, ky anulim është në shkelje ligjore nga AK dhe këtë shkelje ligjore kërkohet të permisohen nga OSHP duke e detyruar AK-në të zbatojë rregullat e prokurimit publik.

Në vendimin e OSHP-se nr. 2023/0251 i datës 23.06.2023 theksohet anulimi i aktivitetit të prokurimit nga AK bje ndesh me qëllimin e nenit 8 (Planifikimi i Prokurimit), nenit 9 (Përcaktimi i nevojave qëduhet përmbushur), nenin 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit dhe nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Sepse praktikë e mira dhe standardet e prokurimit ndërkombëtar nuk e pranojnë anulimin e një aktiviteti të prokurimit në çdo fazë dhe për çfarë do arsyeje, dhe kjo shkelje për anulim është bërë nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin për Furnizim me lidhëse elastike. Oferta e ofertuar në vlerën 33,984.00 € është dukshëm më e ulët se buxheti i parashikuar nga AK në vlerën 45,000.00€, oferta e ofertuar është më e ulët 24.48% ose 11,016.00€ në krahasim me buxhetin e planifikuar nga AK. Nuk qëndron asnjë fakt dhe arsye ligjore për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit i paraparë me LPP-ne dhe rregulloren për prokurimin publik. Ketu ka indicje për të drejtën që kërkohet nga OE që i takon me ligj edhe të bëhet anulimi i aktivitetit vetëm për të mos shpërblyer me kontratë OE "UNIVERS-M SHPK".

Në pajtim me argumentet ligjore të prezentuara nëpërmjet kësaj ankese, ju lutem, shih të bashkëngjitur si pjesë e përbashkete të kësaj Kërkesë të gjitha faktet gjegjësisht provat e prezentuara që deshmojnë qartë shkeljet ligjore të Autoritetit Kontraktues..

Për çdo shoshitje/verifikim të argumenteve tona ligjore të prezentuara nëpërmjet fakteve të bashkëngjitura, përfaqësuesit e Kompanisë sone, janë të gatshëm të ofrojnë sqarime ligjore dhe teknike për Autoritetin Kontraktues në fazën e shqyrtimit të ankesës për të i mundësuar Autoritetit Kontraktues të konstatojë në mënyrë të drejtë, paanëshëm, objektive dhe profesionale gjendjen faktike për marrjes së vendimit ligjor.

Duke marrë parasysh argumentet, faktet, provat e potencuara dhe arsyetimet e ofruara me arsyetim ligjor dhe pretendimet për dëpозitat ligjore të shkelura nga Autoriteti Kontraktues të specifikuara në pikën 7 të kësaj ankese, Kompania 'Univers - M', sh.p.k i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, të nxjerre:

VENDIM

- të anulohet njoftimi i vendimit të AK-se datë 16.08.2023,
- të aprovojë ankesën të bazuar të OE "Univers – M" sh.p.k., dhe
- lenden e kontestuar të kthejë në RI-VLERESIM të ofertave duke propozuar për dënie të kontratës ofertën e përgjigjshme me çmimin më të ulët e cila plotëson kërkesat, kriteret e dosjes së tenderit sipas rregullave të prokurimit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kontrata në vlerën 33,984.00€; Ankesat në vlerën 800.00€; dhe dëmet tjera materiale dhe jo materiale që mund të na shkaktohen sipas Ligjit për

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
- b) një kopje të publikimit "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- d) Vendimin e OSHP-se 2023/0251 dt.23.06.2023.*
- e) Njoftimi mbi vendimin e AK date 09.08.2023.*
- f) Letren standarde të kerkese për sqarimin e tenderit date 14.07.2023.*
- g) Pergjigjjen e datës 15.07.2023 ndaj letrës standarde të kërkesës për sqarim e tenderit date 14.07.2023.*
- h) Kerkesen për rishqyrtim në AK me dt.14.08.2023*
- i) Pergjigje e AK nr.5324 dt.16.08.2023.në kerkesen për rishqyrtim*
- j) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP*

Verejtje: Te gjitha pretendimet tona tonambeshteten ne fakte bashkangjitur ankeses , materialin e të gjithë tenderueseve e gjeni ne proceduren e prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit në Autoritetin Kontraktues – Korporatën Energjetike të Kosovës sh.a.